



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr.200 dt.24.12.1998

**“PER
MIRATIMIN E NJE NDRYSHIMI NE KESHILLIN DREJTUES TE
NDERMARRJES ENERGJITIKE UJESJELLES
TE MJEDISEVE STUDENTORE”**

Këshilli Bashkiak i qytetit të Tiranës, në mbledhjen e tij dt.24.12.1998, pasi mori në shqyrtim relacionin e Drejtorisë së Përgjithshme të Punëve Publike dhe Shërbimeve për “Miratimin e një ndryshimi në Këshillin Drejtues të Ndërmarrjes Energjitike Ujësjiellës të Mjediseve Studentore”, mbështetur në ligjin “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Pushtetit Lokal”, Nr.7572, dt.10.06.1992, Udhëzimin Nr.6, dt.03.09.1992 “Për Zbatimin e Ligjit Nr.7572, Ligjit Nr.7582, dt.13.07.1992 “Për Ndërmarrjet Shtetërore”

VENDOSI

1. Të miratojë Z.Astrit Kurti anëtar i Këshillit Drejtues të Ndërmarrjes Energjitike Ujësjiellës të Mjediseve Studentore, me detyrë Përgjegjësi i Kaldajës së Qytetit Studenti në këtë ndërmarrje, në vend të Z.Kastriot Zurba (larguar nga Ndërmarrja me dëshirën e tij).
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtorja e Përgjithshme e Punëve Publike e Shërbimeve si dhe Ndërmarrja Energjitike Ujësjiellës Mjediseve Studentore.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

ORHAN SAKIQI